

Hagë, 14 korrik 2025

PËRMBLEDHJE E AKTGJYKIMIT TË APELIT

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës, çështja gjyqësore nr. KSC-CA-2024-03

Në vijim do të gjeni përmbledhjen e Aktgjykimit të Apelit të lëshuar nga Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit, lexuar nga ky panel.

Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit është mbledhur sot për të shqiptuar Aktgjykimin e Apelit në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës*. Ky Aktgjykim shqiptohet publikisht, në emër të popullit të Kosovës, dhe në prani të të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës.

Kjo përmbledhje përmban pikat themelore të apeluara dhe konstatimet kryesore të Panelit të Apelit dhe nuk është pjesë e Aktgjykimit zyrtar dhe autoritativ të Apelit. Aktgjykimi me shkrim është i vetmi dokument autoritativ i konstatimeve të Panelit të Apelit. Aktgjykimi i Apelit do të vihet në dispozicion në formë elektronike pas kësaj seance. Një kopje e legalizuar e Aktgjykimit të Apelit në anglishte do t'i jepet z. Pjetër Shala sot dhe versioni në gjuhën shqipe do t'i jepet kur të jetë gati.

Dhomat e Specializuara u krijuan në lidhje me akuza të rënda për trajtim çnjerëzor, vrasje të personave dhe krime të tjera të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000.

Ky Aktgjykim i Apelit shënon një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara pasi është aktgjykimi i dytë i apelit në një çështje për krime lufte në këtë gjykatë. Aktgjykimi është një hap i rëndësishëm drejt vendosjes së drejtësisë për viktimat dhe llogaridhënies.

Ky Aktgjykim trajton apelin kundër konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me përgjegjësinë e z. Shala, anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ose UÇK, për krime të

kryera në fabrikën e metalit në Kukës, në Republikën e Shqipërisë, (fabrika e metalit në Kukës, ose FMK), afërsisht midis 17majit 1999 dhe 5 qershorit 1999.

Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykses shqiptoi Aktgjykimin, në të cilin e shpalli z. Shala fajtor për tri akuza për krime lufte. Ai u shpall fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme (Pikat 1, 3 dhe 4) dhe i pafajshëm për krimin e luftës të trajtimit mizor (Pika 2). Trupi Gjykses e dënoi z. Shala me dënim të njësuar prej 18 vjetësh burgim në të cilin llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

Trupi Gjykses konstatoi se, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, në FMK, së paku 18 personave iu hoq liria nga z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së. Trupi Gjykses konstatoi se kjo ndodhi në kontekstin e konfliktit të armatosur jondërkombëtar ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se, gjatë të njëjtës periudhë kohore, z. Shala dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i mbajtën të ndaluarit në FMK në kushte ndalimi çnjerëzore dhe poshtëruese dhe i keqtrajtuuan rregullisht, si fizikisht dhe psikologjikisht, me qëllim marrjen e informacionit ose të deklaratave pranuese prej tyre dhe/ose për t'i ndëshkuar, frikësuar, detyruar dhe/ose diskriminuar për arsye politike. Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se personi i përmendur si viktimë e vrasjes së paligjshme vdiq gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në FMK, më 5 qershor 1999, ose rreth kësaj date, nga pasojat e plagëve me armë zjarri të shkaktuara nga një anëtar i UÇK-së në prani të z. Shala, dhe refuzimit të trajtimit mjekësor të duhur. Megjithëse, u konstatua se z. z. Shala *nuk* ishte personi që qëlloi me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykses konstatoi se ai ishte i pranishëm në dhomë kur u qëllua viktimë e vrasjes së paligjshme dhe mori pjesë gjithashtu në keqtrajtimin e tij, para se të qëllohej dhe pasi u qëllua me armë zjarri.

Z. Shala dorëzoi apel kundër verdikteve të fajësisë sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës dhe një numri konstatimesh të Trupit Gjykses të bëra në lidhje me to.

Z. Shala kërkoi që Paneli i Apelit të anulojë verdiktet e fajësisë të shpallura nga Trupi Gjykses sipas Pikave 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës ose, si alternativë, t'ia kthejë çështjen Trupit Gjykses për rigjykim, ose, si alternativë, të ulë dënimin e dhënë.

Z. Shala apeloj gjithashtu Urdhrin për Zhdëmtim të lëshuar nga Trupi Gjykses më 29 nëntor 2024, në të cilin tetë viktimave pjesëmarrëse në proces iu akorduan dëmshpërblime. Aktgjykimi mbi Apelin e z. Shala kundër Urdhrit për Zhdëmtim do të lëshohet më vete, më vonë.

Paneli i Apelit dëgjoi parashtrimet gojore të palëve dhe pjesëmarrësve më 15 dhe 16 maj 2025.

Apeli i z. Shala kundër Aktgjykimit përmban 14 pika, në të cilat ai parashtron argumente në lidhje me pretendime për gabime ligjore, faktike dhe në përcaktimin e dënimit nga Trupi Gjykses.

Paneli i Apelit së pari i referohet standardit të shqyrtimit të apeleve kundër aktgjykimeve të trupit gjykses sipas nenit 46 të Ligjit. Paneli i Apelit mund të lërë në fuqi, prapësojë ose ndryshojë aktgjykimet e trupit gjykses dhe të marrë masa të përshtatshme për arsyet vijuese: (i) “gabim ligjor që zhvlerëson aktgjykimin”; (ii) “gabim faktik që ka shkaktuar gabim gjyqësor”; ose (iii) “gabim në përcaktimin e dënimit”. Për arsyet e shtjelluara më gjerësisht në Aktgjykimin e Apelit, Paneli rikujton diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykses për vlerësimin e provave dhe përcaktimin e dënimit të përshtatshëm. Në lidhje me këtë Paneli thekson se nuk do t'i përmbysë lehtësisht konstatimet faktike të Trupit Gjykses, sepse trupi gjykses është në pozitën më të mirë për dëgjimin, vlerësimin dhe peshimin e dëshmive të paraqitura gjatë gjykit, përveçse kur vlerësimi i trupit gjykses është tërësisht i gabuar. Gjithashtu, Paneli i Apelit nuk do të ndërhyjë në dënimin e dhënë nga Trupi Gjykses, përveçse kur ka bërë gabim të dallueshëm në ushtrimin e diskrecionit të vet, ose nuk ka zbatuar dispozitat ligjore përkatëse.

Trupi Gjykues thekson se për të mundësuar që kjo Përmbledhje të jetë publike, dëshmitarët e mbrojtur dhe viktimat nuk do të identifikohen dhe do të përmenden përgjithësisht vetëm kur është e nevojshme. Më shumë hollësi jepen në Aktgjykimin e Apelit.

Paneli tani do të përmbledhë konstatimet kryesore të Aktgjykimit të vet, duke filluar me Pikën 9 të Apelit të z. Shala për pretendime të shkeljes së të drejtave të Mbrojtjes.

Pretendime për shkelje të të drejtave për gjykim të drejtë

Së pari, në nënpikën 9A të Apelit, z. Shala pretendon shkelje të përsëritura të ZPS-së në lidhje me nxjerrjen e materialeve dhe thekson konkretisht shembullin e W02540-s, duke pretenduar se nxjerrja me vonesë e materialeve në lidhje me këtë dëshmitar e dëmtoi atë, sepse ndryshe do ta kishte thirrur dëshmitarin për të dëshmuar. Paneli i Apelit konstaton se pretendimet e përgjithshme të z. Shala për shkelje në lidhje me nxjerrjen e materialeve duhet të rrëzohen, sepse u mungon baza e nevojshme. Në lidhje me aspektin e nxjerrjes me vonesë të provave lidhur me W02540-n, sikurse shtjellohet më gjerësisht në Aktgjykimin e Apelit, konkretisht në lidhje me Pikën 10 të Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë pretendimin për dëm dhe se Trupi Gjykues nuk gaboi që rrëzoi argumentet e z. Shala gjatë gjykimit. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 9A të Apelit.

Së dyti, në nënpikën 9B të Apelit, në lidhje me pretendimin e z. Shala se Trupi Gjykues vuri kufizime të tepruara për dëshmitarët që mund të thirreshin nga Mbrojtja, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala ka hequr dorë nga e drejta e tij për të kundërshtuar në fazën e apelit vendimin e Trupit Gjykues që urdhëroi heqjen e pesë dëshmitarëve nga Lista e Dëshmitarëve të Mbrojtjes. Ai as nuk e ngriti këtë kundërshtim gjatë gjykimit, as nuk provoi rrethana të posaçme që përligjin shqyrtimin e argumenteve të tij për të parën herën në fazën e apelit. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon nënpikën 9B të Apelit.

Së treti, në nënpikën 9C të Apelit, z. Shala kundërshton faktin se gjykimi filloi përpara se Mbrojtja të ishte gati për të dhe para se të përfundonte hetimet. Paneli i Apelit

konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë gabim të Trupit Gjykses dhe konstaton më tej se Trupi Gjykses në fakt mori masa për t'i mundësuar Mbrojtjes kryerjen e hetimeve dhe përgatitjet e saj për gjykim. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 9C të Apelit.

Së fundi, në nënpikën 9D të Apelit, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses nuk pranoi ndikimin në aftësinë e tij për t'u mbrojtur të kohës që ka kaluar midis ngjarjeve të paraqitura në Aktakuzë dhe gjykimit. Paneli i Apelit konstaton se z. Shala thjesht përsërit argumentet e rrëzuara gjatë gjykimit pa provuar se si rrëzimi i tyre prej Trupit Gjykses ishte i gabuar. Paneli konstaton më tej se z. Shala nuk ka arritur të provojë se si aftësia e tij për të përgatitur mbrojtjen e vet u cëna rëndë si rezultat i kohës që ka kaluar. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 9D të Apelit.

Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 9 të Apelit.

Pretendime për gabime në lidhje me deklaratat e mëparshme të z. Shala

Z. Shala ngriti pretendime për një numër gabimesh të Trupit Gjykses në lidhje me pranimin dhe vlerësimin e deklaratave të mëparshme të tij, në kuadrin e disa pikave të Apelit , konkretisht në Pikat 1, 2 dhe nënpikën 8B. Paneli i ka shqyrtuar këto pika bashkërisht. Ndër deklaratat e mëparshme të z. Shala të përmendura në Aktgjykimin e Apelit përfshihen, deklarata dhënë Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) më 2005, deklarata dhënë TPNJ-së më 2007, deklarata dhënë autoriteteve belge më 2016 dhe deklarata dhënë autoriteteve belge më 2019.

Së pari, në Pikën 1 të Apelit, z. Shala kundërshtoi pranimin dhe mbështetjen e Trupit Gjykses në deklaratat e mëparshme të tij me pretendimin se ato ishin marrë në shkelje të së drejtave të tij për gjykim të drejtë. Paneli rikujton se në një vendim të lëshuar gjatë fazës së gjykimit, Dhoma e Gjykatës së Apelit trajtoi aspekte të ngjashme dhe la në fuqi vendimin e Trupit Gjykses për të pranuar si prova deklaratat dhënë TPNJ-së më 2005 dhe 2007. Rrjedhimisht, sa u përket deklaratave dhënë TPNJ-së, Paneli nuk arrin të

kuptoje se si mbështetja në prova të pranuar sipas rregullit gjatë gjykimit, në vetvete mund të përbëjë shkeljes që pretendoi z. Shala.

Në lidhje me deklaratat dhënë autoriteteve belge, Dhoma e Gjykatës së Apelit konstatoi në një vendim të mëparshëm, se z. Shala nuk u lejua të kontaktonte avokat gjatë intervistës me autoritetet belge më 2016 dhe se Trupi Gjykues gaboi që arriti në një konstatim të ndryshëm. Megjithatë, duke pasur parasysh garancitë procedurale të tjera që iu ofruan zotit Shala në kontekst të kësaj interviste, u konstatua se kuadri i shkeljes ishte i kufizuar dhe Dhoma e Gjykatës së Apelit la në fuqi vendimin e Trupit Gjykues që gjykoi se deklarata dhënë autoriteteve belge në 2016 “nuk ishte e papranueshme”. Në fund të fundit, Trupi Gjykues nuk u mbështet në deklaratën dhënë autoriteteve belge më 2016 për konstatimet në Aktgjykim. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentet e z. Shala për të kundërtën. Gjithashtu, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli rrëzon argumentin e z. Shala se për shkak se deklarata dhënë autoriteteve belge më 2016 u mor në shkelje të të drejtave të tij, doktrina e “frutit të pemës helmuese” ndalon përdorimin e deklaratës dhënë autoriteteve belge më 2019.

Sa u përket argumenteve të z. Shala në lidhje me deklaratën dhënë autoriteteve belge më 2019, Dhoma e Gjykatës së Apelit rrëzoi pretendime të ngjashme për shkelje gjatë fazës së gjykimit. Paneli rrëzon gjithashtu argumentin e z. Shala se, Trupi Gjykues shkeli të drejtat e tij për gjykim të drejtë që, në Aktgjykim, u mbështet kryesisht në deklaratën dhënë autoriteteve belge më 2019. Në lidhje me këtë, Paneli konstaton se deklarata dhënë autoriteteve belge më 2019 u trajtuar me kujdesin e duhur dhe [Trupi Gjykues] u mbështet në të vetëm kur konfirmohet nga prova të tjera. Paneli rrëzon gjithashtu argumentet e tjera të z. Shala në lidhje me këtë deklaratë. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 1 të Apelit.

Në Pikën 2 të Apelit, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykues gaboi që refuzoi të merrte vendim në lidhje me pranueshmërinë e shumë provave jогоjore gjatë procesit. Për arsyet e shpjeguara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli do të trajtojë vetëm argumentet në

lidhje me deklaratat dhënë autoriteteve belge më 2016 dhe 2019. Paneli është i mendimit se rregulla 138(1) e Rregullores, lexuar së bashku me nenin 40(6)(h) të Ligjit, nuk e detyron trupin gjykues për të vendosur në lidhje me pranueshmërinë e provave brenda një afati të caktuar. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se në Vendimin Kornizë mbi Provat Jogojore, të datës 17 mars 2023, Trupi Gjykues vendosi të vlerësonte pranueshmërinë e materialeve që janë prova jogojore në fund të gjykimit, gjatë kuvendimit në lidhje me aktgjykimin. Megjithatë, Trupi Gjykues parashikoi mundësinë e lëshimit të vendimeve mbi pranueshmërinë e provave që paraqiten gjatë gjykimit, në rrethana të jashtëzakonshme. Paneli gjykon se përdorimi i këtij përjashtimi ishte i përligjur në lidhje me deklaratat dhënë autoriteteve belge duke pasur parasysh llojin inkriminues të provave që kundërshtohen dhe për arsye se palët kishin kërkuar shprehimisht që Trupi Gjykues të lëshonte një vendim mbi pranueshmërinë e atyre deklaratave. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala ka provuar se Trupi Gjykues gaboi që nuk lëshoi një vendim mbi pranueshmërinë e deklaratave dhënë autoriteteve belge pas paraqitjes ose në kuadër të Vendimit Kornizë mbi Provat Jogojore. Megjithatë, z. Shala nuk arriti të provonte dëmin që iu shkaktua në lidhje me këtë. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 2 të Apelit.

Në lidhje me nënpikën 8B të Apelit, Paneli rishikoi me kujdes konstatimet e Trupit Gjykues të apeluara nga z. Shala, por konstaton se ai nuk arriti të provonte se formulimi që përdori Trupi Gjykues në vlerësimin për disa deklarata të mëparshme të tij ia kaloi Mbrojtjes detyrimin e vërtetimit. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 8B të Apelit.

Pretendime për gabime në lidhje me respektimin e parimit të ligjshmërisë prej Trupit Gjykues

Në Pikën 3 të Apelit, z. Shala parashitroi se, me shpalljen e tij fajtor për ndërmarrje kriminale të përbashkët, ose NKP, për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, Trupi Gjykues shkeli parimin e ligjshmërisë të

mishëruar në nenin 33 të Kushtetutës, nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, dhe nenin 15 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Së pari, z. Shala argumentoi se zbatimi i drejtpërdrejtë i të drejtës zakonore ndërkombëtare nga Trupi Gjykses, dhe rrjedhimisht verdikti i fajësisë për krime sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, shkeli parimin e ligjshmërisë duke pasur parasysh se as Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, që ishte në fuqi në kohën përkatëse, as Kushtetuta e Kosovës nuk lejojnë zbatimin drejtpërdrejt të normave të së drejtës ndërkombëtare, përveç nëse përmbushin “standardin e dualizmit”. Duke pasur parasysh se argumentet e z. Shala janë trajtuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Dhoma e Gjykatës së Apelit dhe Dhoma e Gjykatës Kushtetuese, Paneli i Apelit i rrëzon argumentet e tij.

Së dyti, z. Shala parashtroi se NPK-ja si formë e përgjegjësisë penale, dhe krimi i luftës i ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar, nuk ishin pjesë e legjislacionit të Kosovës, as nuk ishin të përcaktuara sipas të drejtës zakonore ndërkombëtare më 1999. Ai argumentoi gjithashtu se ato as nuk ishin të parashikueshme, as të disponueshme për të akuzuarin, në kuptimin që ai nuk mund të dinte se cilat veprime dhe forma të përgjegjësisë penale përbënin krime. Në lidhje me këtë, z. Shala parashtroi se Trupi Gjykses duhej të kishte marrë parasysh, ndër të tjera, mospasjen e tij të një pozite në UÇK dhe shkollimin e pamjaftueshëm, paqartësitë në lidhje me elementet e krimit të ndalimit arbitrar dhe mungesën e kapacitetit organizativ ose të ndonjë kapaciteti tjetër të UÇK-së më 1999.

Paneli vëren se z. Shala përsërit kryesisht argumente tashmë të paraqitura dhe të rrëzuara nga Dhoma e Gjykatës së Apelit në vendime të mëparshme në të cilat u mbështet Trupi Gjykses. Ai konstaton se z. Shala nuk ka arritur të tregojë arsye bindëse që do të çonin Panelin në një konstatim të ndryshëm në lidhje me juridiksionin e Dhomave të Specializuara mbi NPK-në, ose ndalimin arbitrar në një konflikt të

armatosur jondërkombëtar. Në lidhje me argumentet e tjera të z. Shala për parashikueshmërinë, Paneli i gjykon jobindëse duke pasur parasysh vlerësimin tërësor të faktorëve relevantë, provave të administruara dhe konstatimeve të tjera të Trupit Gjykues.

Bazuar në sa më lart, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë gabim, dhe rrjedhimisht rrëzon Pikën 3 të Apelit.

Pretendime për gabime në lidhje me Aktakuzën

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala në lidhje me Aktakuzën. Në Pikën 5 të Apelit, z. Shala pretendoi se Trupi Gjykues gaboi që e shpalli fajtor për akuzat e ndalimit arbitrar dhe torturës në lidhje me së paku 18 viktima, ndërkohë që në Aktakuzë ai akuzohej vetëm në lidhje me nëntë viktima. Paneli i Apelit fillimisht vëren se Trupi Gjykues nuk analizoi nëse Aktakuza kishte mangësi në këtë aspekt. Paneli gjykon se Trupi Gjykues duhej të kishte dhënë arsyet e vendimit për verdiktet e fajësisë kundër z. Shala në lidhje me një numër më të madh personash sesa u paraqit fillimisht në Aktakuzë. Paneli i Apelit konstaton se mosdhënia e këtyre arsyeve prej Trupit Gjykues përbën gabim ligjor.

Në lidhje me pretendimin se Aktakuza kishte mangësi, Paneli mban parasysh vendimet e mëhershme të Dhomës së Gjykatës së Apelit në këtë çështje se në Aktakuzë janë paraqitur si duhet identitetet dhe numri i viktimave të pretenduara. Sidoqoftë, ky konstatim u bazua në premisën se provat e ZPS-së kufizoheshin në “së paku nëntë persona”. Duke pasur parasysh kuadrin e kufizuar të kësaj çështjeje, Paneli gjykon se nevojitet një shkallë më e lartë konkretësie sesa në çështjet e një shkalle më masive dhe se kriteret e argumentimit në lidhje me viktimat e pretenduara janë përkatësisht më të larta. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se shprehja “së paku nëntë persona” në Aktakuzë nuk ishte mjaftueshëm konkrete dhe se Aktakuza pati mangësi në lidhje me nëntë personat e tjerë që pretendohet se u mbajtën të ndaluar në FMK.

Për arsyet e përshkruara më me hollësi në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se kjo mangësi në Aktakuzë ishte sidoqoftë e korrigjueshme, pasi nuk përbënte akuzë të re – që paraqiste një bazë të re për verdiktin e fajësisë, të ndryshme nga akuzat tashmë të pranishme në Aktakuzë– dhe nuk çoi në një transformim rrënjësor të akuzave të ZPS-së kundër z. Shala.

Paneli konstaton se mangësia në Aktakuzë më pas u korrigjua nëpërmjet informacionit të përfshirë në Dosjen Paraprake të ZPS-së, ku përmenden shprehimisht ndalimi arbitrar dhe keqtrajtimi i së paku 18 personave. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se z. Shala u njoftua si duhet se akuzohej në lidhje me së paku 18 viktimat dhe se atij iu dha mundësia të përgatiste mbrojtje të njëmendtë kundër këtyre akuzave. Këtë përfundim e përforcon dhe analizimi i sjelljes së mbrojtjes së z. Shala, që pasqyron dijeninë e tij se akuzohej në lidhje me pretendime që përfshinin së paku 18 viktimat.

Për rrjedhojë, Paneli i Apelit konstaton se gabimet e Trupit Gjykses nuk zhvlerësojnë vendimin e tij për shpalljen fajtor të z. Shala mbi këtë bazë. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 5 të Apelit.

Paneli i Apelit tani do të shqyrtojë nënpikën 4A të Apelit, në të cilën z. Shala kundërshtoi faktin se Trupi Gjykses e shpalli fajtor në bazë të një Aktakuze me mangësi, të cilës i mungonin hollësitë e mjaftueshme në lidhje me (i) identitetet e tre anëtarëve të pretenduar të NKP-së; dhe (ii) identitetet e viktimave të pretenduara.

Së pari, në lidhje me anëtarët e NKP-së, Paneli vë në dukje se, në Aktgjykim, Trupi Gjykses identifikoi z. Osman Kryeziu dhe z. Fatmir Limaj si anëtarë të NKP-së, ndërkohë që në Aktakuzë ata nuk përmendeshin shprehimisht si të tillë. Sa i përket z. Sokol Dobruna, Paneli vëren se në kundërshtim me pretendimin e z. Shala, Trupi Gjykses nuk e përmendi atë me emër si anëtar të NKP-së. Duke rikujtuar se në Aktakuzë nuk ka nevojë të paraqiten provat që vërtetojnë faktet materiale të pretenduara që mbështesin akuzat, Paneli gjykon se identifikimi i z. Kryeziu dhe z. Fatmir Limaj si anëtarë të NKP-së nuk përbën fakt material, por ka të bëjë me provat.

Rrjedhimisht, Aktakuza nuk ka mangësi, pasi këta persona përfshihen në kategorinë e “disa ushtarëve, policëve dhe rojave të tjera të UÇK-së”, të përmendur në Aktakuzë. Bazuar në sa më lart, Paneli është bindur se Trupi Gjykses nuk gaboi kur në bazë të provave të paraqitura në gjykim, në fund identifikoi z. Kryeziu dhe z. Fatmir Limaj si anëtarë të tjerë të identifikuar të NKP-së.

Së dyti, në lidhje me viktimat, Paneli konstaton se Aktakuza nuk ishte mjaftueshëm konkrete në lidhje me identitetet e nëntë viktimave të tjera. Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses gaboi që nuk trajtoi aspektin nëse Aktakuza kishte mangësi dhe që përfundimisht nuk konstatoi se Aktakuza ishte e mangët në këtë aspekt. Megjithatë, Paneli konstaton se mangësia në Aktakuzë u korrigjua nga informacioni që përmbante Dosja Paraprake e ZPS-së dhe se z. Shala u njoftua si duhet për identitetet e viktimave të tjera. Si rezultat, Paneli i Apelit gjykon se gabimet e Trupit Gjykses nuk zhvlerësojnë vendimin për shpalljen fajtor të z. Shala mbi këtë bazë. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon nënpikën 4A të Apelit.

Në lidhje me nënpikën 4B të Apelit, z. Shala argumentoi se Aktakuza përmbante akuza të shumëfishta të palejueshme për torturë dhe trajtim mizor. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses gaboi në qasjen lidhur me akuzat e shumëfishta, as se ai u dëmtua si rezultat i akuzave të shumëfishta për torturë dhe trajtim mizor në Aktakuzë. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 4B të Apelit.

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj qasjes së Trupit Gjykses në lidhje me vlerësimin e dëshmitarëve. Këto lidhen me Pikat 6 dhe 10 të Apelit.

Pretendime për gabime në vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshmitarët kyç të ZPS-së

Paraprakisht, Paneli i Apelit rikujton se Trupi Gjykses ka diskrecion të gjerë për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre, dhe se Paneli nuk i rrëzon lehtë konstatimet faktike të Trupit Gjykses në lidhje me këtë

aspekt. Paneli rikujton gjithashtu se e drejta e të akuzuarit për mendim të arsyetuar nuk kërkon analizë të hollësishme të besueshmërisë së dëshmitarëve, në qoftë se Trupi Gjykses jep arsyet për pranimin e dëshmisë së dëshmitarit, pavarësisht nga ndonjë mospërputhje e pretenduar apo juridikisht thelbësore.

Në nënpikat 6A, 6B dhe 6C të Apelit, z. Shala kundërshtoi vlerësimin prej Trupit Gjykses të besueshmërisë së tre dëshmitarëve kyç të ZPS-së. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses kishte keqpërdorur diskrecionin e vet në mënyrën se si vlerësoi besueshmërinë e TW4-01-shit, W04733-shit dhe W01448-ës. Në lidhje me kundërshtimet e z. Shala të paraqitura në nënpikën 6D të Apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses gaboi në konstatimin se nuk kishte komprometim të provave ose marrëveshje ndërmjet dëshmitarëve të ZPS-së, si dhe mes anëtarëve të familjes së W04733-shit. Së fundi, në lidhje me nënpikën 6E të Apelit, sikurse shtjellohet më tej dhe në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses keqpërdori diskrecionin e vet dhe zbatoi standarde të dyfishta kur arriti në përfundime të ndryshme në lidhje me mospërputhjet në dëshmitë e dëshmitarëve

Në përfundim, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 6 të Apelit.

Pretendime për gabime në vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshmitarët e Mbrojtjes

Në Pikën 10 të Apelit, z. Shala kundërshton vlerësimin e Trupit Gjykses për dëshmitarët e Mbrojtjes, konkretisht se Trupi Gjykses shqyrtoi faktorë jorelevantë, si përkrahja e dëshmitarëve për UÇK-në, mendimet politike të tyre dhe armiqësia kundrejt Dhomave të Specializuara.

Paneli fillimisht konstaton se Trupi Gjykses artikuloi saktë qasjen ndaj vlerësimit të provave në këtë çështje gjyqësore, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve dhe mbështetshmërisë në dëshmitë e tyre, para se të mbështetej në to.

Siç shtjellohet më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli gjithashtu gjykon se Trupi Gjykses vlerësoi me kujdes besueshmërinë e dëshmitarëve të kundërshtuar të Mbrojtjes dhe dha arsyetim të mjaftueshëm në mbështetje të përfundimeve të veta për trajtimin e provave të tyre me kujdes shumë të madh ose si prova aspak të besueshme.

Paneli gjithashtu gjykon se qasja përputhëse e Trupit Gjykses në vlerësimin e të gjithë dëshmitarëve, nuk përmban asnjë tregues për anshmëri konkrete kundër dëshmitarëve të Mbrojtjes. Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses gaboi apo keqpërdori diskrecionin e vet në vlerësimin e dëshmitarëve të Mbrojtjes.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 10 të Apelit.

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj mbështetjes së Trupit Gjykses në prova të paverifikuara. Këto lidhen me Pikat 7 dhe (pjesërisht) 12 të Apelit.

Pretendime për gabime në lidhje me mbështetjen e Trupit Gjykses në prova të paverifikuara

Në Pikën 7 të Apelit, z. Shala argumentoi se, në kundërshtim me rregullën 140(4)(a) të Rregullores, Trupi Gjykses u bazua vetëm ose në masë vendimtare në prova të paverifikuara për nxjerrjen e atyre që, në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i quan “konstatime themelore të apeluara”, konkretisht në lidhje me synimin kriminal (elementi mendor) për ndalimin arbitrar dhe synimin kriminal e veprimin e fajshëm (elementi material) për torturën; si dhe në lidhje me anëtarësinë e z. Shala në NKP, kontributin e qenësishëm të tij në të dhe qëllimin e përbashkët të NKP-së. Gjithashtu, në Pikën 7 të Apelit, z. Shala apeloj verdiktet e fajësisë së tij për torturë ndaj katër personave dhe ndalim arbitrar të gjashtë personave. Kundërshtimin e z. Shala kundër verdiktit të fajësisë së tij për torturë të ushtruar ndaj një personi të pestë, që fillimisht z. Shala e paraqiti në nënpikën 8A të Apelit të tij, Paneli e ka trajtuar në kuadër të Pikës 7 të Apelit.

Fillimisht për konstatimet themelore të apeluara të Trupit Gjykses në lidhje me elementet e veprave penale të torturës dhe ndalimit arbitrar, si dhe në lidhje me NKP-në, Paneli i Apelit vëren se Trupi Gjykses u bazua, në masë të ndryshme, në prova të paverifikuara për formulimin e konstatimeve faktike që ishin baza e konstatimeve themelore të apeluara, Megjithatë, në lidhje me këtë, Trupi Gjykses u mbështet gjithashtu në dëshmitë gojore të dëshmitarëve që u paraqitën në gjykim. Në veçanti, Paneli vëren se secili prej konstatimeve themelore të apeluara u mbështet pjesërisht nga konstatimet faktike të Trupit Gjykses, të cilat nga ana e tyre bazoheshin gjerësisht në dëshmi gojore në sallën e gjyqit. Këto konstatime kanë të bëjnë me pjesëmarrjen personale në dy raste konkrete të z. Shala në marrjen në pyetje dhe keqtrajtimin e të ndaluarve, konkretisht, në ato të cilave, në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit u referohet si incidenti i 20 majit 1999 dhe incidenti i qëllimit me armë zjarri në këmbë (më 4 qershor 1999 ose rreth kësaj date). Gjithashtu, konstatimet themelore të apeluara në lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal për torturë; në lidhje me anëtarësinë e z. Shala në NKP; dhe në lidhje me qëllimin e përbashkët të NKP-së, u mbështeten pjesërisht nga konstatime faktike që nga ana e tyre bazoheshin, ndër të tjera, në dëshmi të një numri dëshmitarësh në gjykim. Këtu përfshihen, për shembull, konstatimet faktike në lidhje me praktikën e organizuar të arrestimit të personave të ndaluar në FMK; rastet e tjera të keqtrajtimit të të ndaluarve në FMK; dhe praninë e veprimtarinë e z. Shala në FMK.

Bazuar në sa më lart, Paneli arrin në përfundimin se z. Shala nuk arriti të provonte se Trupi Gjykses u bazua vetëm ose në masë vendimtare në prova të paverifikuara për konstatimet themelore të apeluara në lidhje me elementët e ndalimit arbitrar dhe torturës si dhe me të NKP-së, në kundërshtim me rregullën 140(4)(a) të Rregullores, dhe, rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e z. Shala sipas Pikës 7 (dhe Pikës 12 pjesërisht) të Apelit që kanë të bëjnë me konstatimet themelore të apeluara.

Në vijim, Paneli i Apelit do të trajtojë apelimin e z. Shala kundër verdiktit të fajësisë së tij për torturë në lidhje me pesë persona konkretë. Gjatë vlerësimit të themelësisë së

argumentit të z. Shala, dhe në përputhje me të drejtën penale ndërkombëtare dhe parimet përkatëse të të drejtave të njeriut, Paneli i Apelit fillimisht analizoi provat e përdorura të keqtrajtimit konkret të këtyre pesë personave. Paneli gjithashtu analizoi provat në të cilat u mbështet Trupi Gjykses për të konfirmuar keqtrajtimin konkret të tyre, dhe, në lidhje me këtë, mbajti parasysh se vendimi nëse mbështetja në prova të paverifikuara është “vendimtare” varet nga vlera provuese e provave mbështetëse.

Në këtë aspekt, Paneli mbajti parasysh mbështetjen e Trupit Gjykses në prova që konfirmonin praktikën e keqtrajtimit kolektiv të të ndaluarve në FMK. Megjithatë, Paneli i Apelit mbajti parasysh edhe konstatimin e Trupit Gjykses se keqtrajtimi kolektiv i të ndaluarve në FMK përfundoi faktikisht më 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date, me mbërritjen e rojeve të reja dhe me përmirësimin material si rezultat i kësaj të kushteve të ndalimit në FMK, përfshirë ndërprerjen e keqtrajtimit fizik të të ndaluarve. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit rikujton se palët nuk qenë në gjendje të citonin ndonjë provë nga provat e administruara në gjykim që sugjeronte se Trupi Gjykses kishte gabuar në konstatimin në lidhje me këtë aspekt, ose që do të mbështeste konstatimin se keqtrajtimi kolektiv dhe sistematik i të ndaluarve në FMK vazhdoi pas asaj date.

Gjatë vlerësimit të mjaftueshmërisë së kësaj praktike konfirmuese të keqtrajtimit kolektiv të të ndaluarve, Paneli i Apelit së pari shqyrtoi nëse Trupi Gjykses kishte përcaktuar se personi ishte ndaluar *para* këtij ndryshimi në kushtet e ndalimit në FMK më 5 qershor 1999 ose rreth kësaj date (me fjalë të tjera, ndërkohë që vazhdonte keqtrajtimi kolektiv i të ndaluarve). Së dyti, Paneli shqyrtoi gjithashtu nëse zotit Shala i ishte dhënë mundësia të verifikonte provat në të cilat ishte bazuar Trupi Gjykses për të bërë një përcaktim të tillë kritik.

Pasi kreu një vlerësim tërësor të provave në përputhje me këtë qasje, Paneli i Apelit konstaton se në gjykim nuk u paraqitën dëshmi gojore të keqtrajtimit konkret të këtyre pesë personave, as dëshmi gojore se këta persona ishin mbajtur të ndaluar në FMK para përfundimit të keqtrajtimit kolektiv të të ndaluarve në FMK më 5 qershor 1999

ose rreth kësaj date. Ndonëse arsyet për këto konstatime jepen me hollësi në Aktgjykimin e Apelit, Paneli thekson se kjo mangësi ishte kritike jo vetëm për konfirmimin, por edhe për konstatimet e Trupit Gjykses se këta persona u vunë në kushte çnjerëzore ndalimi gjatë kohës së ndalimit të tyre në FMK. Në fakt, në lidhje me tre persona, Paneli vëren se nuk u paraqit asnjë dëshmi gojore për vetë ndalimin e tyre në FMK pikësëpari. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Trupi Gjykses u bazua në një masë vendimtare në prova të paverifikuara kur e shpalli fajtor z. Shala për torturë ndaj këtyre pesë personave.

Së fundi, në lidhje me kundërshtimin e z. Shala ndaj verdiktit të fajësisë së tij për ndalim arbitrar në lidhje me gjashtë persona konkretë, Paneli së pari konstaton se për shpalljen fajtor të z. Shala për ndalimin arbitrar të katër prej gjashtë personave në fjalë, Trupi Gjykses u mbështet, në masë të ndryshme, në dëshmi gojore për rrethanat e ndalimit të tyre në FMK. Trupi Gjykses gjithashtu u mbështet në provat e “praktikës së veprimit” ku personave të arrestuar dhe të ndaluar në FMK iu mohuan garancitë procedurale bazë. Pasi analizoi provat për këto praktikave, Paneli i Apelit konstaton se ato bazoheshin në një masë të madhe në dëshmi gojore. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk provoi se verdiktet e fajësisë së tij për ndalim arbitrar në lidhje me këta katër persona, u bazuan vetëm ose në një masë vendimtare në prova të paverifikuara dhe rrëzon kundërshtimet e tij sipas Pikës 7 të Apelit në lidhje me to.

Sidoqoftë, nga ana tjetër, për dy personat e tjerë që ishin objekt i kundërshtimit të z. Shala nuk u paraqitën dëshmi gojore as për vetë ndalimin e tyre në FMK, e aq më pak për rrethanat e ndalimit të tyre atje. Paneli rikujton se u kishte kërkuar palëve të bënin parashtrime në seancën e apelit lidhur me mundësinë e gjetjes së provave të tilla në dokumentacionin e gjyimit. Në lidhje me këtë, Paneli vë në dukje se palët nuk qenë në gjendje të citonin prova që, sipas Panelit të Apelit, mund të konsideroheshin bindshëm si të tilla. Paneli gjithashtu mbajti parasysh se nuk u dhanë dëshmi konfirmuese të ndalimit të këtyre dy personave në FMK, prej dëshmitarëve të ZPS-së të cilët dëshmuan në sallën e gjyqit. Bazuar në faktin se të vetmet prova të

administruara në gjykim për vetë ndalimin e këtyre dy personave në FMK janë të paverifikuara, Paneli i Apelit gjykon se verdikti i fajësisë së z. Shala për ndalimin arbitrar të këtyre dy personave u bazua në masë vendimtare në prova të paverifikuara.

Si përfundim në lidhje me Pikën 7 të Apelit, Paneli i Apelit konstaton se verdiktet e fajësisë së z. Shala për torturë ndaj pesë personave dhe ndalim arbitrar të dy personave u dhanë në shkelje të rregullës 140(4)(a) të Rregullores dhe i prapëson këto verdikte. Rrjedhimisht, Paneli miraton pjesërisht Pikën 7 të Apelit dhe rrëzon pjesën tjetër të kundërshtimeve të z. Shala të paraqitura në këtë Pikë. Ndikimi i përfundimeve të arritura prej Panelit të Apelit në lidhje me dënimin e z. Shala do të shtjellohet më poshtë.

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me krimin e luftës të ndalimit arbitrar. Këto lidhen me Pikat 8, 11 dhe 12 të Apelit.

Pretendimet për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi krimin e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 1 e Aktakuzës)

Në nënpikën 8A, dhe Pikat 11 dhe 12 të Apelit, z. Shala kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar sipas nenit 14(1)(c) të Ligjit - mbi të cilat u bazua vendimi i fajësisë për Pikën 1 të Aktakuzës - të kryer në bazë të NKP I.

Paneli së pari do të trajtojë argumentet e z. Shala në lidhje me veprimin e fajshëm për krimin e luftës të ndalimit arbitrar. Fillimisht, Paneli i Apelit thekson se elementi i veprimit të fajshëm mund të përmbushet nëse provohet se të ndaluarit u mbajtën pa bazë ligjore, ose se ndalimi nuk përmbushi garancitë procedurale bazë.

Paneli i Apelit së pari do të trajtojë pretendimin për gabime që burojnë nga konstatimi i Trupit Gjykses se ndalimi i të ndaluarve nuk përmbushi garancitë procedurale bazë.

Paneli i Apelit më pas do të trajtojë pretendimin për gabime që burojnë nga konstatimi i Trupit Gjykses se të ndaluarit u mbajtën pa bazë ligjore.

Sa i përket pretendimit për gabime ligjore, duke qenë se z. Shala kundërshtoi elementet e *veprimit të fajshëm* për krimin e luftës të ndalimit arbitrar, Paneli i Apelit e konstaton këtë argument të pabazë.

Më tej, z. Shala kundërshtoi burimet ligjore ku u mbështet Trupi Gjykses për interpretimin e dy prej tri garancive bazë. Këto garanci janë: detyrimi për të nxjerrë personin e ndaluar para një gjykatësi apo një autoriteti tjetër kompetent, dhe detyrimi për t'i dhënë personit të ndaluar mundësinë për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit.

Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka arritur të provojë gabim në burimet ligjore në të cilat u mbështet Trupi Gjykses. Paneli i Apelit arrin në këtë përfundim duke mbajtur parasysh se: (i) parimi i ligjshmërisë nuk e ndalon gjykatën që të interpretojë dhe qartësojë elementet e një krimi; (ii) objektivat e së drejtës për të drejtat e njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare përgjithësisht përputhen sa i përket ndalimit arbitrar; (iii) z. Shala nuk ka artikuluar se pse parimet e evidentuara nuk vlejné njëjloj si për konfliktet e armatosura ndërkombëtare, ashtu edhe për ato jondërkombëtare; dhe (iv) Dhoma e Gjykatës së Apelit më herët i ka shqyrtuar dhe rrëzuar këto argumente.

Gjithashtu, z. Shala pretendoi se përfundimi i Trupit Gjykses se rishikimi i ndalimit duhet të kryhet nga një autoritet i pavarur përbën një “standard tejet të lartë”. Paneli i Apelit konstaton se në kontekstin e një konflikti të armatosur, funksioni mbrojtës i moslejimit të ndalimit arbitrar do të zhbëhej po qe se autoriteti që bën rishikimin e ndalimit nuk do të ishte i pavarur nga ai që urdhëroi ndalimin, dhe se z. Shala nuk ka arritur të provojë të kundërtën.

Z. Shala gjithashtu kundërshtoi konstatimin e Trupit Gjykses se nuk ka rëndësi nëse “kryesi [i ndalimit arbitrar] është personalisht përgjegjës për mosrespektimin e të

drejtave procedurale të të ndaluarit”. Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka artikuluar se pse Trupi Gjykses gaboi që zbatoi këtë parim në lidhje me një krim luftë në konflikt të armatosur jondërkombëtar.

Duke mbajtur parasysh sa më lart, si edhe arsyetimin e mëtejshëm në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses bëri gabim ligjor kur konstatoi se ndalimi i të ndaluarve nuk përmbushi garancitë procedurale bazë.

Paneli në vijim do të trajtojë pretendimet e z. Shala për gabime faktike.

Z. Shala së pari kundërshtoi konstatimet faktike të Trupit Gjykses në lidhje me garancitë procedurale bazë dhe veçanërisht përfundimin e Trupit Gjykses se të ndaluarit “nuk u nxorën pa vonesë para një gjykatësi apo autoriteti tjetër kompetent”. Z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se asnjë anëtar i UÇK-së në FMK nuk veprroi si autoritet kompetent.

Së pari, Paneli vëren se, megjithëse z. Shala pretendoi se z. Kryeziu ushtronte funksionet e autoritetit kompetent, ai nuk ka arritur të provojë që z. Kryeziu kishte nivelin e duhur të pavarësisë, apo se kishte kompetencë të mbikëqyrte në mënyrë të pavarur ligjshmërinë e ndalimit, apo të urdhëronte lirin e ndonjë të ndaluarit. Paneli i Apelit gjithashtu gjykon se Trupi Gjykses vlerësoi me kujdes dhe në hollësi dëshmitë e TW4-02-shit, TW4-11-shit dhe TW4-04-ës, të cilat konfirmuan se z. Kryeziu nuk kishte kompetencë për mbikëqyrje të pavarur të ligjshmërisë së ndalimit.

Së dyti, Paneli do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj konstatimit të Trupit Gjykses në lidhje me W04733-shin. Sipas Panelit ishte e arsyeshme që Trupi Gjykses të konstatonte se z. Dobruna nuk kreu mbikëqyrje të pavarur të ligjshmërisë së ndalimit të W04733-shit, bazuar në faktin se z. Dobruna e mori në pyetje W04733-shin bashkë me z. Xhemshit Krasniqi, një anëtar i NKP-së që mori pjesë në keqtrajtimin e W04733-shit.

Duke mbajtur parasysh sa më lart, si edhe arsyetimin e mëtejshëm në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton më tej se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se as z. Kryeziu, as z. Dobruna, e as ndonjë anëtar tjetër i UÇK-së, nuk ushtruan funksionet e një gjykatësi apo autoriteti të pavarur, dhe se TW4-11, TW4-04, TW4-02, W04733 dhe TW4-05 nuk u nxorën pa vonesë para një gjykatësi ose një autoriteti tjetër kompetent.

Paneli do të trajtojë tani argumentet e z. Shala në nënpikën 8A të Apelit, konkretisht se Trupi Gjykues gaboi kur nxori deduksione të paarsyeshme në kuadër të konstatimit se të ndaluarve në FMK iu mohuan garancitë procedurale, veçanërisht mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre.

Sa u përket kundërshtimeve të z. Shala në lidhje me TW4-01-shin, viktimën e vrasjes së paligjshme, TW4-11-shin, W01448-ën dhe TW4-05-ën, për arsyt e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit, Paneli është bindur se një gjykues i arsyeshëm faktesh mund të kishte konstatuar, në bazë të tërësisë së provave, se i vetmi përfundim i arsyeshëm ishte se atyre iu mohuan garancitë procedurale dhe mundësia për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre.

Gjithashtu, z. Shala kundërshtoi konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me ndalimin e paligjshëm të shtatë të ndaluarve të tjerë. Duke mbajtur parasysh provat bindëse të administruara për kushtet e ndalimit dhe/ose praktikën e vazhdueshme të mungesës së garancive procedurale në FMK, Paneli është bindur, në lidhje me gjashtë nga të ndaluarit, se një gjykues i arsyeshëm faktesh mund të kishte konstatuar se i vetmi deduksion i arsyeshëm ishte se atyre nuk iu akorduan garanci procedurale.

Në lidhje me të ndaluarin e shtatë, Paneli konstaton se kundërshtimi i z. Shala është i tejkaluar, si rezultat i konstatimeve të mëparshme të Panelit në kuadër të Pikës 7 të Apelit se verdikti i fajësisë së z. Shala për ndalimin arbitrar të këtij të ndaluari u bazua në masë vendimtare në prova të paverifikuara dëshmitarësh. Po kështu, Paneli konstaton se kundërshtimet e z. Shala lidhur me marrjen në pyetje dhe/ose

keqtrajtimin e tre të ndaluarve janë gjithashtu të tejkaluara, bazuar në konstatimet për Pikën 7 të Apelit në lidhje me të njëjtët të ndaluar.

Rrjedhimisht, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses keqpërdori diskrecionin e vet me deduksionet në kuadër të konstatimit se të ndaluarve në FMK iu mohuan garancitë procedurale.

Paneli i Apelit tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala në lidhje me konstatimin e Trupit Gjykses se të ndaluarve iu hoq liria pa bazë ligjore. Më konkretisht, z. Shala pretendoi se Trupi Gjykses gaboi në dy aspekte kur arriti në përfundimin se të ndaluarit “nuk u mbajtën në FMK në bazë të ndonjë akuze penale, dhe se nuk kishte shqetësime për sigurinë që e bënë ndalimin e tyre absolutisht të domosdoshëm”. Z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi (i) që nuk dha mendim të arsyetuar; dhe (ii) që konstatoi se ky përfundim ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm.

Paneli i Apelit gjykon se në arsyetimin e Trupit Gjykses nuk bëhet e qartë nëse u shqyrtua se ndalimi i 18 të ndaluarve ishte absolutisht i domosdoshëm. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vëren se nuk ka ndonjë paragraf më vete në Aktgjykim për këtë aspekt. Sidoqoftë, Trupi Gjykses: (i) duket se mori parasysh që nëntë prej 18 të ndaluarve u akuzuan shprehimisht se ishin spiunë, tradhtarë ose bashkëpunëtorë të armikut; dhe (ii) mori parasysh që të ndaluarit u mbajtën të ndaluar sipas një “praktike veprimi”. Në lidhje me këtë praktikë veprimi, Paneli i Apelit është i mendimit se përfundimet e Trupit Gjykses lënë të kuptohet se të ndaluarit në këtë çështje u vunë në shënjestër për ndalim nga UÇK-ja. Së fundi, Paneli i Apelit thekson argumentet e ZPS-së se të gjithë të ndaluarit i mohuan si të pavërteta akuzat kundër tyre. Paneli i Apelit gjykon se, në qoftë se Trupi Gjykses e mori parasysh këtë kur arriti në konstatimin e kundërshtuar, kjo nuk është e qartë nga arsyetimi i Trupit Gjykses.

Duke mbajtur parasysh sa më lart, si edhe arsyetimin e mëtejshëm në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala ka provuar se Trupi Gjykses nuk dha mendim të arsyetuar kur konstatoi se të ndaluarit “nuk u mbajtën në FMK në bazë të

ndonjë akuze penale, dhe se nuk kishte shqetësime për sigurinë që e bënin ndalimin e tyre absolutisht të domosdoshëm”. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon këtë konstatim dhe miraton, pjesërisht, Pikën 12 të Apelit të z. Shala. Mbi këtë bazë, Paneli i Apelit e gjykon të tejkaluar argumentin e mëtejshëm të z. Shala se Trupi Gjykses gaboi – në kuadër të të njëjtit konstatim – që arriti në përfundimin se ky ishte i vetmi deduksion i arsyeshëm.

Sikurse shpjegohet në Aktgjykimin e Apelit, rrëzimi i këtij konstatimi, në vetvete, nuk ka ndikim në verdiktin e fajësisë së z. Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.

Paneli tani do të trajtojë argumentet e z. Shala në lidhje me synimin kriminal për ndalimin arbitrar.

Së pari, Paneli i Apelit vëren se, krahas konstatimit se sjellja e kryesit ishte e qëllimshme, elementi i synimit kriminal mund të përmbushet duke provuar se kryesi, ose: (i) nuk kishte arsye të besonte se shqetësimet për sigurinë e palëve në konflikt e bënin ndalimin absolutisht të domosdoshëm; ose (ii) e dinte se të ndaluarve nuk u ishin akorduar garancitë e duhura procedurale.

Paraprakisht, dhe duke qenë se prapësoi konstatimin në lidhje me veprimin e fajshëm, se të ndaluarit “nuk u mbajtën në FMK në bazë të ndonjë akuze penale, dhe se nuk kishte shqetësime për sigurinë që e bënin ndalimin e tyre absolutisht të domosdoshëm”, Paneli i Apelit, me nismën e vet, prapëson edhe konstatimin e Trupit Gjykses për synimin kriminal përkatës, se “kryesit, ndër ta dhe z. Shala, nuk kishin arsye të besonin se shqetësimet për sigurinë e bënin ndalimin e këtyre personave absolutisht të domosdoshëm”. Ndikimi i mundshëm i këtij konstatimi, do të shpjegohet pasi të trajtohen kundërshtimet e z. Shala ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me synimin kriminal.

Z. Shala argumentoi se dijenia e tij për krimin e ndalimit arbitrar nuk mund të deduktohet vetëm mbi bazën e pranisë së tij në FMK. Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk nxori përfundimin se z. Shala kishte dijeni për ndalimin arbitrar vetëm

mbi bazën “e pranisë së tij në FMK”. Përkundrazi, përfundimi i Trupit Gjykses për dijeninë e tij u bazua në pjesëmarrjen personale dhe praninë e z. Shala në kryerjen e krimit të ndalimit arbitrar dhe të krimeve të tjera. Paneli i Apelit rrëzoi parashtrimet e tjera të z. Shala në mbështetje të këtij argumenti, për arsyet e shtjelluara në Aktgjykimin e Apelit.

Bazuar në sa më lart, si edhe arsyetimin e mëtejshëm në Aktgjykimin e Apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Shala nuk ka arritur të vërtetojë se Trupi Gjykses gaboi në nxjerrjen e përfundimit se ai përmbushi elementin e synimit kriminal në lidhje me krimin e luftës të ndalimit arbitrar në një konflikt të armatosur jondërkombëtar.

Sidoqoftë, Paneli i Apelit rikujton se ai, me nismën e vet, prapësoi konstatimin e Trupit Gjykses mbi synimin kriminal, se kryesit, ndër të cilët edhe z. Shala, nuk kishin arsye të besonin se shqetësimet për sigurinë e bënin ndalimin e këtyre personave absolutisht të domosdoshëm. Sikurse shpjegohet në Aktgjykimin e Apelit, prapësimi i këtij konstatimi, megjithatë, nuk ndikon në verdiktin e fajësisë të z. Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar.

Paneli tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Shala ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me verdiktin e fajësisë së z. Shala për ndalim arbitrar në bazë të NKP I.

Së pari, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi kur deduktoi ekzistencën e qëllimit të përbashkët të NKP-së nga praktika e veprimit në arrestimin e të ndaluarve, në institucionalizimin e mbajtjes në ndalim dhe keqtrajtimin sistematik të të ndaluarve, ndërkohë që kishte edhe deduksione të tjera të arsyeshme që mund të nxirreshin nga provat e disponueshme.

Për arsyet e diskutuara më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi kur konstatoi se anëtarët e NKP-së kishin qëllimin e përbashkët të ndalimit arbitrar, marrjes në pyetje dhe torturimit të të ndaluarve në FMK, të cilët akuzoheshin se simpatizonin, ose se kishin lidhje me autoritetet serbe. Paneli i Apelit gjithashtu konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që

konstatoi se arrestimi i të ndaluarve u krye sipas së njëjtës praktike të organizuar veprimi.

Rrjedhimisht, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë se, mbi bazën e provave që iu paraqitën Trupit Gjykues, asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk do të mund të nxirrte përfundimin se anëtarët e NKP-së kishin qëllimin e përbashkët të ndalimit arbitrar të të ndaluarve në FMK.

Sa u përket argumenteve të z. Shala se Trupi Gjykues gaboi kur vlerësoi kontributin personal të tij në NKP për ndalimin arbitrar, për arsyet që shpjegohen në Aktgjykimin e Apelit, Paneli konstaton se z. Shala nuk ka arritur të provojë asnjë gabim faktik ose ligjor në konstatimet e Trupit Gjykues dhe në përfundimin se z. Shala dha kontribut të qenësishëm në krimin e ndalimit arbitrar.

Së fundi, Paneli do të trajtojë argumentet e z. Shala se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se ai kishte synimin e përbashkët me anëtarë të tjerë të NKP-së për kryerjen e ndalimit arbitrar, duke qenë se NKP-ja nuk lejon verdikte fajësie bazuar në fajësinë për shkak të anëtarësisë. Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka shpjeguar se si konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me synimin e tij do të përbënin “fajësi për shkak të anëtarësisë”. Sido që të jetë, lidhja midis z. Shala dhe krimit të ndalimit arbitrar nuk rrjedh nga anëtarësia e tij në NKP, por nga kontributi i qenësishëm i tij në NKP dhe synimi i përbashkët me anëtarë të tjerë të NKP-së për të kryer krimin e ndalimit arbitrar dhe për të marrë pjesë në planin e përbashkët që synonte kryerjen e tij. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon argumentin e z. Shala në lidhje me këtë aspekt.

Si përfundim, Paneli i Apelit rrëzon nënpikën 8A, Pikën 11, miraton pjesërisht Pikën 12, dhe rrëzon pjesën tjetër të Pikës 12 të Apelit.

Pretendime për gabime që lidhen me konstatimet e Trupit Gjykses për krimin e luftës të vrasjes së paligjshe (Pika 4 e Aktakuzës)

Paneli do të bëjë tani një përmbledhje të konstatimeve të veta në lidhje me kundërshtimet e z. Shala në Pikën 13 të Apelit.

Z. Shala apeloj konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me krimin e luftës të vrasjes së paligjshe sipas nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, mbi të cilat mbështetet verdikti i fajësisë së tij për Pikën 4 të Aktakuzës, për vrasjen e viktimës së vrasjes së paligjshe, kryer sipas NKP I më 5 qershor 1999, ose rreth asaj date, në FMK. Për t'i trajtuar plotësisht argumentet e z. Shala, Paneli i Apelit fillimisht vlerësoi parashtrimet e z. Shala se Trupi Gjykses gaboi kur deduktoi se vrasja e paligjshe ishte pjesë e qëllimit të përbashkët të NKP-së. Pas kësaj, Trupi Gjykses vlerësoi parashtrimet e z. Shala se Trupi Gjykses gaboi kur konstatoi se ai kishte synimin e nevojshëm për të kryer krimin e vrasjes së paligjshe.

Fillimisht, Paneli vëren se kuadri i synimit të përbashkët të NKP-së në këtë çështje gjyqësore është i ngushtë dhe, në veçanti, karakterizohet nga periudhë e kufizuar kohe prej më pak se tri javësh, nga ndalimi fillestar i të ndaluarve në FMK rreth datës 17 maj 1999 deri në vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshe, më 5 qershor 1999, ose rreth asaj date. Paneli vëren gjithashtu se konstatimi i Trupit Gjykses se në këtë rast qëllimi i përbashkët përfshinte vrasjen e paligjshe, nuk përbën konstatim se FMK ishte një kamp ndalimi i krijuar posaçërisht me qëllimin për të vrarë persona të ndaluar.

Paneli do të trajtojë tani kundërshtimet konkrete të z. Shala lidhur me qëllimin e përbashkët të NKP-së. Së pari, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi që deduktoi se vrasja e paligjshe ishte pjesë e qëllimit të përbashkët të NKP-së bazuar në mënyrën se si u keqtrajtuuan disa të ndaluar. Paneli vlerëson se deduksioni alternativ i propozuar nga z. Shala, se qëllimi i kryesve ishte vetëm që të keqtrajtonin dhe jo që t'i vrisnin të ndaluarit, nuk mbështetet në provat e administruara. Ndër këto prova është keqtrajtimi i rëndë i të ndaluarve, përfshirë gjatë incidentit të 20 majit 1999, kur kryesit

vazhduan t'i rrihnin të ndaluarit me mjete të ndryshme, përfshirë me një armë që u përdor si mjet i fortë, edhe pasi ata kishin humbur vetëdijen. Në lidhje me argumentin e z. Shala se kryesit nuk kishin synimin për të vrarë para ose pas incidentit të qëllimit me armë zjarri në këmbë më 4 qershor 1999, ose rreth asaj date, sepse viktimat e vrasjes së paligjshme u qëlluan me armë zjarri në këmbë dhe u kthye në dhomë të gjallë, Paneli e gjykon këtë argument jobindës bazuar në konstatimet e Trupit Gjykses se: (i) anëtarët e NKP-së vazhduan ta keqtrajtonin viktimën e vrasjes së paligjshme pasi e qëlluan me armë zjarri; (ii) kjo shkaktoi gjakderdhje të madhe që kërkonte ndihmë mjekësore; dhe (iii) në vend që të kërkonin trajtim mjekësor, kryesit vazhduan ta rrihnin viktimën e vrasjes së paligjshme.

Së dyti, z. Shala argumentoi se Trupi Gjykses gaboi kur konstatoi se qëllimi i përbashkët i NKP-së përfshinte vrasjen e paligjshme, duke u mbështetur në deklaratat e bëra nga anëtarë të NKP-së, përfshirë nga z. Shala, për të provuar synimin për të vrarë të ndaluarit. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vlerëson fillimisht se, për të vërtetuar se qëllimi i përbashkët i NKP-së përfshinte vrasjen e paligjshme, nuk ishte e nevojshme që Trupi Gjykses të vërtetonte se z. Shala kishte synimin të vraste një person konkret, përkatësisht viktimën e vrasjes së paligjshme, por se ai kishte të njëjtin synim me anëtarët e tjerë të NKP-së. Gjithashtu, Paneli i vlerëson bindëse provat ku u mbështet Trupi Gjykses për të konstatuar se anëtarët e NKP-së kishin synimin për të vrarë. Këto prova përfshijnë: (i) deklarata të ndryshme të pranuar si prova, të cilat diskutohen më tej në Aktgjykimin e Apelit; (ii) fakti që z. Shala mori pjesë në keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme gjatë incidentit të qëllimit me armë zjarri në këmbë më 4 qershor 1999, ose rreth asaj date; dhe (iii) se z. Shala ishte i pranishëm kur anëtarë të tjerë të NKP-së qëlluan me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme dhe pa pasojat e shkaktuara nga kjo. Rrjedhimisht, Paneli gjykon se Trupi Gjykses nuk gaboi kur arriti në përfundimin se qëllimi i përbashkët i NKP-së përfshinte vrasjen e paligjshme, përmes konstatimit se anëtarët e NKP-së, ndër të cilët z. Shala, kishin synimin për të vrarë të ndaluarit.

Së fundi, Paneli trajton kundërshtimin e tretë të z. Shala në lidhje me deduksionin e Trupit Gjykues se vrasja e paligjshme ishte pjesë e qëllimit të përbashkët të NKP-së, bazuar në konstatimin se synimi për të vrarë u manifestua edhe nga refuzimi i qëllimshëm i trajtimit mjekësor për viktimën e vrasjes së paligjshme.

Sa i takon argumentit të z. Shala se provat sugjerojnë që anëtarëve të UÇK-së u erdhi keq për vdekjen e viktimës së vrasjes së paligjshme dhe morën masa të menjëhershme për përmirësimin e kushteve në FMK, Paneli vëren se z. Shala e ngriti këtë argument gjatë gjykimit dhe ai u hodh poshtë nga Trupi Gjykues, që përligj rrëzimin e tij të menjëhershëm në apel.

Sido që të jetë, Paneli rikujton provat e shqyrtuara nga Trupi Gjykues, që, pas incidentit të qëllimit me armë zjarri në këmbë më 4 qershor 1999, ose rreth asaj date, ishte e qartë se viktima e vrasjes së paligjshme kishte nevojë për ndihmë mjekësore, por, megjithatë, në vend që të kërkonin trajtimin mjekësor, kryesit vazhduan ta rrihnin viktimën e vrasjes së paligjshme, i cili më vonë vdiq në ndalim në FMK. Bazuar në prova të mëtijshme të diskutuara në Aktgjykimin e Apelit, si dhe në konstatimet e Trupit Gjykues në tërësi, Paneli gjykon se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykues gaboi që nuk mori parasysh se ndryshimi i kushteve pas vdekjes së viktimës së vrasjes së paligjshme tregoi keqardhjen e anëtarëve të NKP-së.

Sa i takon argumentit të z. Shala se ai nuk kishte asnjë lidhje me urdhrin për refuzimin e trajtimit mjekësor, Paneli i Apelit rikujton se, nga pikëpamja ligjore, nuk është e nevojshme që z. Shala të ketë qenë personalisht i përfshirë në të gjitha faktet mbi të cilat u mbështet Trupi Gjykues për të deduktuar ekzistencën dhe llojin e qëllimit të përbashkët. Paneli vëren gjithashtu se Trupi Gjykues nuk e mbështeti përfundimin se z. Shala kontribuoi në NKP në ndonjë konstatim lidhur me dijeninë, përfshirjen ose përgjegjësinë e tij për refuzimin e trajtimit mjekësor për viktimën e vrasjes së paligjshme. Rrjedhimisht, Paneli rrëzoi argumentin e z. Shala në lidhje me këtë pikë.

Në përfundim, Paneli ka marrë parasysh deduksionet e Trupit Gjykues, të marra së bashku, në konstatimin e vet se vrasja e paligjshme ishte pjesë e qëllimit të përbashkët të NKP-së dhe konstaton se z. Shala nuk ka provuar se asnjë gjykues i arsyeshëm faktesh nuk mund të arrinte në përfundimin e Trupit Gjykues si i vetmi deduksion i arsyeshëm. Rrjedhimisht, Paneli rrëzon, pjesërisht, Pikën 13 të Apelit.

Paneli i Apelit do të trajtojë tani parashtrimet e tjera të z. Shala në Pikën 13 të Apelit se Trupi Gjykues gaboi që konstatoi se ai kishte synimin e nevojshëm për të kryer krimin e vrasjes së paligjshme.

Duke filluar me parashtrimin e z. Shala se nuk është paraqitur asnjë provë në bazë të së cilës Trupi Gjykues do të deduktonte logjikisht dëshirën e tij për të vrarë viktimën e vrasjes së paligjshme, Paneli i Apelit nuk pajtohet me këto parashtrime dhe miraton mbështetjen e Trupit Gjykues në deklaratën e W04733-shit, ku dëshmitari pohoi se z. Shala i tha atij: “Kemi me të vra. Kemi me të ekzekutu”. Paneli miraton gjithashtu mbështetjen e Trupit Gjykues në prova të tjera rrethore në këtë çështje, që mbështesin konstatimin se z. Shala kishte synimin për të kryer krimin e vrasjes së paligjshme. Në lidhje me këtë, Paneli u referohet konstatimeve të Trupit Gjykues për pjesëmarrjen personale dhe aktive të z. Shala në keqtrajtimin e rëndë dhe brutal të të ndaluarve gjatë incidentit të 20 majit 1999. Gjithashtu, Paneli u referohet konstatimeve të Trupit Gjykues se më 4 qershor 1999, ose rreth asaj date, z. Shala mori pjesë në keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme, se ai ishte i pranishëm kur anëtarë të tjerë të NKP-së qëlluan me armë zjarri viktimën e vrasjes së paligjshme, dhe se ai vazhdoi të merrte pjesë në keqtrajtimin e viktimës së vrasjes së paligjshme pas qëllimit të tij me armë zjarri.

Në lidhje me argumentin e z. Shala se, edhe nëse merret me shkallën më të lartë të besueshmërisë, deklarata e W04733-shit tregon vetëm synimin e tij për të vrarë W04733-shin dhe jo viktimën e vrasjes së paligjshme, Paneli rikujton se për krimet e kryera në kuadër të NKP-së nuk është e domosdoshme të vërtetohet pjesëmarrja e të

akuzuarit në kryerjen e një krimi konkret. Në këtë çështje, Trupi Gjykses kishte për detyrë të vërtetonte përgjegjësinë e të akuzuarit në realizimin e qëllimit kriminal të përbashkët, që përfshinte krimin e vrasjes së paligjshme të të ndaluarve në FMK. Paneli është bindur se Trupi Gjykses nuk gaboi që u mbështet në deklaratën e W04733-shit për të arritur në konstatimet e veta. Sa i takon formës së synimit të z. Shala, ndonëse konstatimet e Trupit Gjykses mund të kishin qenë më të qarta në disa aspekte, Paneli vëren se Trupi Gjykses megjithatë theksoi se z. Shala kishte synimin e drejtpërdrejtë për të vrarë.

Paneli shqyrtoi gjithashtu parashtrimet e z. Shala se ai nuk e kreu vetë krimin e vrasjes së paligjshme. Megjithatë, Paneli rikujton se z. Shala nuk u shpall fajtor për kryerjen e veprimit të fajshëm të krimit të vrasjes së paligjshme nga vetë ai, dhe se ligji mbi NKP-në nuk vendos kushtin që i akuzuari të ketë kryer veprimin e fajshëm të krimit, ose të një pjese të tij. Sipas Panelit, rëndësia dhe shkalla e pjesëmarrjes së z. Shala në NKP u vlerësuan siç duhet nga Trupi Gjykses. Rrjedhimisht, argumenti i z. Shala se ai nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt në kryerjen e krimit të vrasjes së paligjshme, nuk cenon konstatimet e Trupit Gjykses për rëndësinë e kontributit të tij në planin e përbashkët.

Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk ka arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se ai ishte pjesë e synimit të përbashkët për të kryer krimin e vrasjes së paligjshme.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit rrëzon Pikën 13.

Pretendime për gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses mbi masën e dënimit

Së fundi, në Pikën 14 të Apelit, z. Shala kundërshton konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me dënimin me 18 vjet burg për tri akuzat për të cilat ai u shpall fajtor.

Së pari, në lidhje me shkallëzimin e zbatueshëm të dënimit, Paneli i Apelit gjykon se Trupi Gjykses nuk gaboi që vlerësoi se duhej të merrte parasysh shkallëzimin e

dënimeve sipas legjislacionit vendor por ato nuk ishin detyruese për të. Paneli i Apelit gjykon gjithashtu se, duke pasur parasysh Aktgjykimin e Dhomës së Gjykatës Kushtetuese në çështjen gjyqësore *Mustafa*, shkallëzimi më i butë i dënimit sipas legjislacionit vendor që duhet të merret parasysh është pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet burgim, në pajtim me Kodin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë të vitit 1976, ndryshuar me Rregulloren 1999/24 të UNMIK-ut. Sido që të jetë, ky shkallëzim i dënimeve sipas legjislacionit vendor nuk kufizon kompetencën diskrecionale të Dhomave të Specializuara për të dhënë dënim më të lartë deri në burgim të përjetshëm, në përputhje me nenin 44(1) të Ligjit. Gjithashtu, për arsyet që shtjellohen më tej në Aktgjykimin e Apelit, Paneli nuk gjykon se është bërë shkelje e parimit të ligjshmërisë sa u takon dispozitave ligjore në lidhje me dënimet.

Së dyti, në lidhje me faktorët që u morën parasysh në dhënien e dënimit, Paneli i Apelit gjykon se z. Shala nuk arriti të identifikonte gabime në lidhje me konstatimet e Trupit Gjykses dhe rrëzon kundërshtimet që lidhen me to.

Sa i takon argumentit të z. Shala se ai nuk kishte rol udhëheqës në FMK, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses gaboi kur nuk i dha peshë të mjaftueshme faktit se z. Shala nuk kishte rol komandues sa i përket kontributit personal të tij në krimin e vrasjes së paligjshme. Paneli i Apelit trajton më poshtë ndikimin e këtij gabimi në dënimin që iu dha z. Shala. Paneli rrëzon pretendimin e z. Shala në lidhje me të gjithë faktorët e tjerë lehtësues.

Së fundi, Paneli i Apelit trajton argumentin e z. Shala lidhur me pretendimet se Trupi Gjykses nuk garantoj barazinë dhe keqpërdori diskrecionin kur dha një dënim paarsyeshmërisht joproporcional krahasuar me çështje gjyqësore të ngjashme. Paneli i Apelit fillimisht rrëzon argumentin e z. Shala se Trupi Gjykses nuk dha mendim të arsyetuar pse vendosi të devijonte aq konsiderueshëm prej atyre dënimeve. Sa i takon themelësisë së ankesës, Paneli rikujton se është plotësisht i vetëdijshëm për diskrecionin e gjerë të Trupit Gjykses në dhënien e dënimit. Megjithatë, duke marrë

parasysh të gjithë faktorët relevantë dhe rrethanat individuale në këtë çështje, Paneli gjykon se ka mospërputhje ndërmjet dënimeve që iu dhanë z. Shala dhe dënimeve të tjera të analizuara prej tij. Paneli gjykon në veçanti se dënimi i formës së prerë me 15 vjet burgim për z. Mustafa, i cili kishte pozitë komanduese, tregon se Trupi Gjykses i tejkaloj kufijtë e diskrecionit të vet, duke i dhënë z. Shala dënime jashtë proporcionit të arsyeshëm krahasuar me çështje të ngjashme. Rrjedhimisht, Paneli miraton pjesërisht kundërshtimet e z. Shala ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses për masën e dënimit, dhe rrëzon pjesën tjetër të argumenteve të tij në kuadër të Pikës 14 të Apelit.

Lidhur me ndikimin e konstatimeve të Panelit të Apelit për gabime në dënimet që iu dhanë z. Shala, Paneli rikujton së pari se ai prapësoi konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me dy viktime të ndalimit arbitrar dhe pesë viktime të torturës. Së dyti, Paneli konstatoi se Trupi Gjykses nuk i dha peshë të mjaftueshme faktit se z. Shala nuk kishte rol komandues në lidhje me krimin e vrasjes së paligjshme. Së treti, Trupi Gjykses keqpërdori diskrecionin e tij duke i dhënë z. Shala dënime joproporcionale.

Rrjedhimisht, Paneli i Apelit e gjykon të arsyeshme që dënimet individuale që iu dhanë z. Shala nga Trupi Gjykses t'i ulë në dënimet në vijim: (i) gjashtë vjet burgim për Pikën 1 të Aktakuzës, krimi i luftës i ndalimit arbitrar i kryer kundër të paktën 16 personave; (ii) 13 vjet burgim për Pikën 3 të Aktakuzës, krimi i luftës i torturës, i kryer kundër të paktën 13 personave; dhe (iii) 13 vjet burgim për Pikën 4 të Aktakuzës, krimi i luftës i vrasjes së paligjshme, i kryer kundër një personi. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit tani duhet të përcaktojë, në bazë të rregullës 163(4) të Rregullores, “një dënim të njësuar që pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të të akuzuarit” që “nuk është më pak i rëndë se dënimi më i rëndë individual i përcaktuar për cilëndo akuzë”. Në lidhje me këtë, Paneli i Apelit vlerëson se dënimi i njësuar me 13 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim që prej arrestimit të tij më 16 mars 2021, pasqyron tërësinë e veprimtarisë kriminale të z. Shala në këtë çështje.

Paneli i Apelit thekson se kjo ulje e dënimeve të z. Shala nuk sugjeron aspak se krimet për të cilat ai është shpallur fajtor dhe dënuar nuk janë të rënda.

Së fundi, Paneli i Apelit thekson se ka lënë në fuqi verdiktin e fajësisë së z. Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes (Pikat 1, 3 dhe 4 të Aktakuzës) për të cilat u konstatua se a mban përgjegjësi penale individuale.

Si koment i përgjithshëm, Paneli i Apelit rikujton se Dhomat e Specializuara kanë juridiksion vetëm mbi persona, jo grupe apo organizata. Në përputhje me këtë, Paneli i Apelit rithekson se as UÇK-ja, as populli i Kosovës nuk ishin objekt i këtij procesi, por se Paneli ka trajtuar vetëm sjelljen konkrete të z. Shala.

Vendim

Për arsyet e lartpërmendura, pasi ka shqyrtuar të gjitha argumentet e paraqitura nga palët dhe pjesëmarrësit, Paneli i Gjykatës së Apelit, në bazë të nenit 46 të Ligjit dhe rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

MIRATON pjesërisht Pikën 7, pjesërisht Pikën 12, dhe pjesërisht Pikën 14, të Apelit të z. Shala;

PRAPËSON, pjesërisht, verdiktet e fajësisë për Pikat 1 dhe 3 të Aktakuzës, në lidhje me pjesët e tyre që bazohen në ndalimin arbitrar të dy personave dhe në torturimin e pesë personave;

RRËZON apelin e z. Shala për të gjitha aspektet e tjera;

LË NË FUQI pjesën tjetër të verdiktit të fajësisë së z. Shala për krimin e luftës të ndalimit arbitrar në bazë të neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 1 të Aktakuzës, krimin e luftës të torturës në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 3 të Aktakuzës, dhe krimin e luftës të vrasjes së paligjshme në bazë të neneve 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit sipas Pikës 4 të Aktakuzës;

LË NË FUQI dënimin me gjashtë vjet burgim për Pikën 1 të Aktakuzës;

ANULON dënimin me 16 vjet burgim në lidhje me Pikën 3 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me 13 vjet burgim;

ANULON dënimin me 18 vjet burgim në lidhje me Pikën 4 të Aktakuzës dhe **CAKTON** një dënim me 13 vjet burgim;

ANULON dënimin e njësuar me 18 vjet burgim për z. Shala dhe **CAKTON** një dënim të njësuar me 13 vjet burgim për z. Shala, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim;

VENDOS që ky Aktgjykim të zbatohet me efekt të menjëhershëm në bazë të rregullës 185(1) të Rregullores;

URDHËRON që, në pajtim me nenin 50(1) të Ligjit dhe rregullën 166(3) të Rregullores, z. Shala të mbetet në paraburgim të Dhomave të Specializuara deri në finalizimin e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin; dhe

DO TË SHQYRTOJË Apelin e z. Shala kundër Urdhrit për Zhdëmtim.